



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 77

7 dhjetor

2011

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i GJEDNJ
datë 8.3.2011

Çështja “Eltari kundër Shqipërisë”, ankimi nr.16530/06.....

3

SEKSIONI I KATËRT
APLIKIMI NR.4921/06

VENDIM
VIOLETA RIZI
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 8 nëntor 2011, në një Dhomë të përbërë nga:

Lech Gralicki, President

David Thór Björgvinsson

Päivi Hirvelä

George Nicolaou

Ledi Bianku

Zdravka Kalaydjieva,

Vincent A. De Gaetano, gjykatës

dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,

Duke marrë parasysh aplikimin e mësipërm, të paraqitur më 10 nëntor 2006,

Duke marrë parasysh vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur, si edhe vërejtjet e dorëzuara si kundërpërgjigje ndaj të parave nga aplikuesja,

pasi ka shqyrtuar çështjen, vendos si më poshtë:

FAKTET:

1. Aplikuesja, Znj. Violeta Ngjela, lindur Rizi, është shtetase shqiptare, e lindur në vitin 1938 dhe jeton në Durrës. Ajo u përfaqësua përpara gjykatës nga z. E. Todhe, një avokat, i cili e ushtron profesionin në Durrës. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u prezantua nga përfaqësuesja e atëhershme e saj, znj. E. Hajro nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

2. Faktet e çështjes, siç u parashtruan nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

3. Më 22 korrik 1993, Gjykata e Rrethit të Durrësit (Gjykata e Rrethit) i njohu aplikueses të drejtat e pronësisë nga ana e babait mbi një sipërfaqe toke me përmasat 520 m² të pozicionuar në qytetin e Durrësit (vendim vërtetim fakti). Në një datë të papërcaktuar, një ndërtesë gjashtëkatëshe u ndërtua mbi atë sipërfaqe toke, duke përfshirë bar-restorant “Primavera”, të ndodhur në katin përdhes.

4. Në një datë të papërcaktuar, presidenti i atëhershëm i Gjykatës së Kasacionit bëri një kërkesë për rishikim të vendimit të datës 22 korrik 1993. Më 18 nëntor 1994, Gjykata e Kasacionit vendosi ta hedhë poshtë atë vendim me arsyen se gjykata më e ulët nuk kishte realizuar një hetim të detajuar dhe e rihapi çështjen për një ekzaminim të ri. Më 17 janar 1995, pas një kërkesë për interpretim, Gjykata e atëhershme e Kasacionit arriti në përfundimin se vendimi i saj i datës 18 nëntor 1994 nuk kishte pasur ndonjë efekt në rezultatin e procedurave të përcaktuara nga gjykata e rrethit në vendimin e datës 5 maj 1994 (shiko më poshtë paragrafin 7).

5. Më vonë, procedurat e ridëgjimit u shtynë nga gjykata e rrethit në një datë të papërcaktuar, duke qenë se edhe vetë aplikuesja e humbi interesin për çështjen.



1. Procedurat për rikthim të pronës palëve të treta (Ks-të)

6. Më 1 prill 1994, Komisioni i Durrësit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave – “Komisioni”, i njohu Ks-ve (palët e treta) titullin e trashëguar të pronësisë mbi një hapësirë toke me përmasat 1,830 m² (vendimi nr.1 i Komisionit), duke përfshirë edhe të drejtën për refuzimin e parë që iu ishte bërë për mjediset e bar-restorant “Primavera”.

7. Në një datë të papërcaktuar, Ks-të i kërkuan Gjykatës së Rrethit t’ia njihnin të drejtën e pronësisë mbi hapësirën e tokës në të cilën ishte ndërtuar “Primavera”. Më 5 maj 1994, Gjykata e Rrethit, duke u mbështetur në vendimin e saj të datës 22 korrik 1993 (shiko paragrafin 3 më sipër), nuk e pranoi kërkesën e tyre. Ajo e anuloi vendimin nr.1 të Komisionit dhe i njohu aplikueses dhe fëmijëve të saj të drejtat e pronësisë mbi tokën prej 520 m². Në një datë të papërcaktuar, Ks-të apeluan.

8. Më 16 shtator 1994, Gjykata e Apelit Durrës mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit duke i njohur të drejtën e pronësisë aplikueses dhe fëmijëve të saj mbi sipërfaqen prej 520 m². Megjithatë, ajo e hodhi atë pjesë të vendimit të Gjykatës së Rrethit, i cili kishte anuluar vendimin nr.1 të Komisionit, duke qenë se Komisioni nuk ishte ftuar si palë gjatë proceduarve. Në një datë të papërcaktuar, Ks-të apeluan në Gjykatën e Kasacionit.

9. Më 22 nëntor 1994, Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta. Duke gjykuar në bazë të fakteve, ajo nuk i pranoi ankesat e Ks-ve duke iu referuar tërheqjes së tyre nga çështja. Kështu, hyri në fuqi vendimi i Komisionit i datës 1 prill 1994.

2. Procedurat për kthimin e tokës aplikuesit

10. Duke interpretuar vendimin e Gjykatës së Kasacionit të datës 22 nëntor 1994, i cili i njëjti aplikueses dhe fëmijëve të saj të drejtën e pronësisë së trashëguar për sipërfaqen e tokës më 2 shkurt 1995 Komisioni i njohu aplikueses dhe fëmijëve të saj sipërfaqen e tokës prej 520 m² (vendimi nr.2 i Komisionit), duke përfshirë të drejtën e refuzimit të parë për sa kishte të bënte me ambientet e “Primavera-s”. Më 21 shkurt 1995, fëmijët e aplikueses ia dhuruan pjesët e tyre të barabarta aplikueses, me anë të një kontrate dhurimi.

11. Më 11 shkurt 1995, u realizua një kontratë shitjeje midis një kompanie shtetërore, NTUS, Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP) dhe aplikueses ku kjo e fundit kërkoi 1,607,310 lekë shqiptare për ambientet e “Primavera-s” .

12. Gjithashtu, aplikuesja u pajis me një certifikatë regjistrimi të pronësisë (nr.6085) pranë zyrës për regjistrimin e pronave të patundshme, më 21 shkurt 1995.

3. Procedurat në lidhje me vlefshmërinë e vendimit nr.2 të Komisionit dhe kontratës së shitjes.

13. Më 18 nëntor 1995, Ks-të dorëzuan një ankesë në Gjykatën e Rrethit, ku kërkonin anulimin e vendimit nr.2 të Komisionit. Sipas dosjes, rezulton se aplikuesja nuk ishte palë në këto procedura.

14. Më 16 nëntor 1995, Gjykata e Rrethit e anuloi vendimin nr.2 të Komisionit. Sipas vendimit të Gjykatës së Kasacionit të datës 22 nëntor 1994 (shiko më sipër paragrafin 9), u arrit në përfundimin se vendimi nr.2 i Komisionit ishte lëshuar në shkelje të ligjit, duke thyer të drejtën për pronësi të aplikueses. Më tej Gjykata e Rrethit vuri në dukje se, përderisa aplikuesja nuk kishte ndjekur aplikimin pas shtyrjes së çështjes së saj, sipas vendimit të Gjykatës së Kasacionit të datës 18 nëntor 1994 (shiko më sipër paragrafin 4), vetë Gjykata e Rrethit refuzoi t’i ndiqte procedurat.

Ky vendim u bë i formës së prerë për deri sa asnjë apelim nuk u arkivua kundër tij.

15. Duke qenë se vendimi nr.2 i Komisionit u shpall i pavlefshëm, më 3 prill 1996, AKP-ja dhe Ks-të paraqitën një ankesë në Gjykatën e Rrethit kundër kontratës së shitjes, duke pretenduar se ajo ishte e pavlefshme.

16. Më 2 tetor 1997, Gjykata e Rrethit të Kavajës e anuloi kontratën e shitjes, duke u mbështetur mbi të njëjtin arsyetim dhe mbi vendimin e datës 16 tetor 1995 (shiko më sipër paragrafin 14). Ajo vendosi se shuma e paguar, e indeksuar për të marrë parasysh inflacionin, duhej t'i kthehej aplikueses. Më 13 tetor 1997, aplikuesja apeloi.

17. Më 20 maj 1998, Gjykata e Apelit e Tiranës e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit të Kavajës dhe e paraqiti çështjen për t'u riezaminuar nga një formacion tjetër i po asaj gjykate, duke deklaruar si më poshtë:

“Gjatë riezaminimit të çështjes, Gjykata e Rrethit duhet të marrë në konsideratë çdo dyzim të sipërfaqeve të tokës të përcaktuar nga vendimet e Komisionit... Gjykata e Rrethit duhet të identifikojë saktë palët, të thërrasë Komisionin dhe të organizojë një studim topografik për të hetuar dhe për të sqaruar çështjen e mësipërme.”

18. Më 7 prill 2000, Gjykata e Rrethit Durrës e deklaroi vendimin nr.2 të Komisionit të pavlefshëm. Ajo deklaroi si të pavlefshme edhe kontratën e shitjes dhe urdhëroi AKP-në të rimburonte shumën e paguar nga aplikuesja, e indeksuar për të pasur parasysh inflacionin. Aplikuesja apeloi në një datë të papërcaktuar.

19. Më 29 qershor 2000, Gjykata e Apelit Durrës (Gjykata e Apelit) e shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo konkludoi se vendimi nr.2 i Komisionit ishte ende në fuqi për deri sa nuk ishte kundërshtuar në gjykatat vendase. Asnjë vërejtje nuk u bë në lidhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 16 tetor 1995 (shiko më sipër paragrafin 14). Procedurat e iniciuara nga Ks-të u hodhën poshtë. Në një datë të papërcaktuar, Ks-të apeluan në Gjykatën e Lartë.

20. Më 22 nëntor 2001, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe e shtyu çështjen për riezaminim. Ajo konkludoi se Gjykata e Apelit nuk kishte marrë parasysh të gjitha ankesat e Ks-ve.

21. Më 7 tetor 2002, Gjykata e Apelit mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës së datës 7 prill 2000. Ajo arriti në përfundimin, *inter alia*, si më poshtë:

“Gjykata e Kasacionit me një vendim... në 1996 ... bëri një interpretim të vendimit ... më 22 nëntor 1994. Sipas interpretimit të saj, tërheqja e palëve paditëse [Ks-ve] erdhi si rezultat i deklaramit të tyre si pronarë të hapësirës së tokës, sipas vendimit të Komisionit të datës 1 prill 1994 (vendimi nr.1 i Komisionit).

Vendimi i Gjykatës së Kasacionit, i datës 22 nëntor 1994 nuk ia njohu të akuzuarës (pra, aplikueses) të drejtën e pronës duke bërë që mungesa e kësaj të drejte të mos i shërbente si titull pronësie në bazë të së cilit do të mund të vepronte Komisioni.

E akuzuara argumentoi se titulli i saj i pronësisë bazohej në vendimin e Gjykatës së Rrethit, të datës 22 korrik 1993. Megjithatë, ky vendim u rrëzua nga vendimi i Gjykatës së Kasacionit, i datës 18 nëntor 1994.”

22. Më 11 nëntor 2002, aplikuesja apeloi në Gjykatën e Lartë.

23. Më 1 korrik 2004, Gjykata e Lartë e mbështeti vendimin me shumicë votash. Ajo konfirmoi se aplikueses nuk i ishte njohur e drejta për pronësi, duke konkluduar se Komisioni jo vetëm kishte bërë shkelje procedurale duke ia kaluar të drejtën e pronës aplikueses, por gjithashtu, kishte keqinterpretuar të dhënat e çështjes së aplikueses. Gjykata e Lartë urdhëroi që shuma e paguar nga aplikuesja të rimbursohej sipas kushteve të vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës, të datës 7 prill 2000. Më 28 janar 2005 aplikuesja dorëzoi një ankesë kushtetucionale në Gjykatën Kushtetuese.

24. Më 7 shkurt 2005, Gjykata Kushtetuese e deklaroi si të papranueshme ankesën e aplikueses, duke konkluduar se ajo nuk paraqiste ndonjë shkelje të së drejtës për t'u ndjekur në një seancë gjyqësore.



Procedurat në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 2004

25. Më 24 tetor 2005, AKP-ja urdhëroi që shuma prej 1,607,310 t'i kthehej aplikueses sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 2004.

26. Më 10 mars 2011, aplikuesja informoi Gjykatën me shkrim se vendimi ishte zbatuar në një datë të papërcaktuar. Aplikuesja nuk paraqiti dokumente mbështetëse, pavarësisht kërkesës së sekretarisë në letrën e datës 18 shkurt 2011 për t'i paraqitur këto dokumente.

4. Procedurat në lidhje me kërkesën për rishikim përpara Gjykatës së Lartë

27. Më 11 prill 2005, aplikuesja paraqiti kërkesën përpara Gjykatës së Lartë për rishikim të vendimit të saj, të datës 1 korrik 2004 në bazë të të dhënave dhe fakteve të reja. Ajo, me anë të një letre në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, u ankua, *inter alia*, se dy nga tre ekspertët të cilët kishin përgatitur raportin e ekspertëve nuk ishin licencuar nga autoritetet.

28. Më 28 nëntor 2005, Gjykata e Lartë nuk e pranoi aplikimin. Ajo iu referua vendimeve të mëparshme të gjykatës, mori parasysh arsyet për kërkesën e aplikueses për rishikim dhe konkludoi se kërkesa nuk përputhej me nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (shiko më poshtë "Ligjin përkatës vendas"). Gjykatësi N.K., i cili kishte qenë pjesë e shumicës e cila kishte marrë vendimin kundër aplikueses në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 1 korrik 2004, ishte anëtar i bankës.

29. Më 6 mars 2006, aplikuesja bëri apelim kushtetucional.

30. Në një datë të papërcaktuar, aplikuesja e ribëri përsëri kërkesën e saj për rishikim.

31. Më 24 mars 2006, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë atë duke e vlerësuar si tërësisht të njëjtë me kërkesën e mëparshme.

32. Më 27 shtator 2006, Gjykata Kushtetuese e deklaroi të papranueshme kërkesën e aplikueses, duke konkluduar se çështjet e ngritura ishin pjesë e juridiksionit të gjykatave më të ulëta.

5. Informacion shtesë

33. Me anë të një letre të datës 1 nëntor 2007, aplikuesja informoi sekretarinë se ajo kishte hapur procedura kundër AKP-së për rimbursim të shpenzimeve të bëra për mirëmbajtjen dhe rinovimin e bar-restorant "Primavera".

34. Më 16 qershor 2006 dhe më 20 dhjetor 2007, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit, respektivisht, morën vendim në favor të aplikueses. Palët nuk kanë sjellë kopje të vendimeve të gjykatave. Megjithatë, një apelim në Gjykatën e Lartë është ende në proces.

B. Ligji përkatës vendas

1. Kushtetuta

35. Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë pohojnë si më poshtë:

"Neni 42 § 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

"Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

“Neni 142 § 3

Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

2. Kodi i Procedurës Civile (“KPC”)

36. Nenet 494-502 të KPC-së përcaktojnë rishikimin e vendimeve të gjykatës. Neni 494 parashikon që rishikimi i vendimit final mund të ndodhë, *inter alia*, kur: (a) zbulohen rrethana të reja ose të dhëna të reja me shkrim, të cilat janë të rëndësishme për çështjen, dhe që nuk janë bërë të njohura për palën përkatëse gjatë procedurave; ose (b) provohet se deklaratimet e dëshmitarëve ose opinionet e ekspertëve në të cilat është bazuar vendimi kanë qenë false.

37. Sipas nenit 496 të KPC-së, kërkesa për rishikim paraqitet brenda 30 ditëve që prej ditës në të cilën pala e cila bën kërkesën ka pasur dijeni për të dhënat që mundësojnë rishikimin, dhe, në çdo rast, jo më vonë se një vit prej ditës në të cilën të dhënat që mundësojnë rishikimin kanë dalë në dritë. Neni 498 i KPC-së pohon se vendimi për mospranimin e kërkesës për rishikim merret nga Gjykata e Lartë pa praninë e palëve.

ANKESAT

38. Aplikuesja bëri një sërë kërkesash në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës. Fillimisht ajo u ankua se vlefshmëria e vendimit nr.2 të Komisionit dhe kontrata e shitjes ishin të padrejta, duke qenë se gjykatat vendase kishin bërë një vlerësim të gabuar të të dhënave. Më tej ajo vijoi duke pretenduar se vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 11 nëntor 2005, i mungonin arsyetimet e duhura. Gjithashtu, ajo u ankua për mungesë paanshmërie të bankës së Gjykatës së Lartë të datës 11 nëntor 2005, duke iu referuar prezencës së gjykatësit N.K., i cili kishte refuzuar më parë apelimin e saj të datës 1 korrik 2004.

39. Më 14 shkurt 2008, kur presidenti i seksionit të katërt i kushtoi vëmendje aplikimit të Qeverisë së paditur, ai gjithashtu vendosi, *pripro motu*, t’i kushtohej vëmendje edhe ankimit për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 1 korrik 2004.

40. Aplikuesja u ankua se padrejtësia e procedurave në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së shitjes kishte çuar drejt shkeljes të së drejtës së saj për pronësi për sa kishte të bënte me ambientet e bar-restorant “Primavera”, sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Ajo insistoi që t’i rikthehej sipërfaqja e tokës prej 520 m².

LIGJI

A. Neni 6 § 1: Ankesat

1. Për sa ka të bëjë me pretendimin për padrejtësi gjatë procedurave mbi vlefshmërinë e vendimit nr.2 të Komisionit dhe të kontratës së shitjes

41. Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka të bëjë me çështjen, pohon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave të tij civile dhe të detyrimeve të tij ...çdo individ ka të drejtën për një seancë ...të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

42. Gjykata përsërit se në përputhje me nenin 35 § 1 të Konventës, ajo e ekzaminon një ankesë nëse “të gjitha mjetet vendase janë konsumuar” dhe nëse ajo është dorëzuar “brenda një periudhe prej gjashtë muajsh prej datës në të cilën është marrë vendimi final”. Gjykata e pranon aplikimin e vendimit gjashtëmuajor edhe në mungesë të kundërshtimit përkatës nga Qeveria (shiko “Belaousof dhe të tjerët kundër Greqisë”, nr.66296/01, § 38, 27 maj 2004; “Miroshnik kundër Ukrainës”, nr.75804/01, § 55, 27 nëntor 2008; dhe “Toner kundër Mbretërisë së Bashkuar” (vendim), nr.8195/08, 15 shkurt 2011).



43. Në lidhje me këtë situatë Gjykata përsërit se neni 35 § 1 i Konventës kërkon që mjetet e vetme për t'u konsumuar janë ato të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të ofruar ndreqje të shkeljeve të pretenduara. Megjithatë, një aplikues nuk është i detyruar të mbështetet në mjete të cilat nuk janë të përshtatshme ose të efektshme (shiko midis autoriteteve të tjera, “Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë”, 16 shtator 1996, §§ 65-67, Raportet e Gjykimeve dhe të vendimeve 1996-IV; “Selmouni kundër Francës” [GC], nr.25803/94, § 74, ECHR 1999-V; dhe “Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë” (vendim) nr.46113/99, 3843/02, 1375/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04 dhe 21819/04, § 70, ECHR 2010-...). Kështu, nëse asnjë mjet efektiv nuk është i disponueshëm për aplikuesin, kufiri kohor përfundon gjashtë muaj pas datës së akteve apo masave për të cilat ai ankohet, ose pas datës së njoftimit të atij akti apo efekteve dhe ndikimeve të tij mbi aplikuesin (shiko “Younger kundër Mbretërisë së Bashkuar” (vendim), nr.57420/00, ECHR 2003-I; dhe “Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë” [GC], nr.16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, § 157, ECHR 2009-...). Ndjekja e kompensimeve të cilat nuk përmbushin kërkesat e nenit 35 § 1 nuk do të merren në konsideratë nga Gjykata për të vendosur datën finale ose për të llogaritur fillimin për ushtrimin e vendimit gjashtëmujor (shiko “Prystavska kundër Ukrainës” (vendim), nr.21287/02, 17 dhjetor 2002; dhe “Sapeyan kundër Armenisë”, nr.35738/03, § 21, 13 janar 2009).

44. Si rregull i përgjithshëm, Gjykata e pezullon çështjen ligjore nëse një aplikim për rigjykim, ose për rihapje, apo kërkesa të ngjashme të jashtëzakonshme nuk kanë marrë në konsideratë nenin 35 § 1 të Konventës (shiko, për shembull, “Denisov kundër Rusisë” (vendim), nr.33408/03, 6 maj 2004; “Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar” (vendim), nr.32567/06, 17 shkurt 2009; dhe “Laska dhe Lika kundër Shqipërisë”, nr.12315/04 dhe 17605/04, §§ 50-51, 20 prill 2010). Në po të njëjtën mënyrë, kompensimet të cilat nuk kanë limite kohore të përcaktuara, duke krijuar në këtë mënyrë pasiguri dhe duke e bërë të pavlefshëm vendimin gjashtëmujor të nenit 35 § 1 të Konventës, nuk janë kompensime të efektshme sipas nenit 35 § 1 (shiko Denisov, cituar më sipër; “Galstyan kundër Armenisë”, nr.26986/03, § 39, 15 nëntor 2007; Williams, cituar më sipër; dhe “Tucka kundër Mbretërisë së Bashkuar” (vendim), nr.34586/10, 18 janar 2011). Veçanërisht, gjykata vëren se ajo vazhdimisht nuk i ka pranuar aplikimet në të cilat aplikuesit i kanë paraqitur ankesat e tyre brenda gjashtë muajve nga vendimet, duke mos i pranuar kërkesat e tyre për të rihapur procedurat, për arsye se vendime të tilla nuk do të mund të konsideroheshin “vendime finale” sipas nenit 35 § 1 të Konventës (shiko, midis autoriteteve të tjera, “Kolu kundër Finlandës” (vendim), nr.56463/10, 3 maj 2011; “Berdzenishvili kundër Rusisë” (vendim), nr.31697/03, ECHR 2004-II; “Riedl-Riedenstein dhe të tjerët kundër Gjermanisë” (vendim), nr.48662/99, 22 janar 2002; dhe “Babinsky kundër Sllovakisë” (vendim), nr.35833/97, 11 janar 2000).

45. Gjykata vëren se procedurat, të cilat ndeshën kundërshtime, përfunduan më 7 shkurt 2005. Në vijim, aplikuesja paraqiti dy kërkesa për rishikim, të cilat u kundërshtuan më 27 shtator 2006. Në bazë të normave të legjislacionit përkatës, dhe veçanërisht në bazë të parashikimeve të KPC-së, është i qartë fakti se ekzaminimi dhe rezultati i rishikimit të një vendimi final të gjykatës është në varësi të vullnetit të Gjykatës së Lartë. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se kërkesa e aplikueses nuk respektonte atë çka parashikohej në nenin 494 të KPC-së.

46. Në vijim, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi “final” në çështjen konkrete ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 7 shkurt 2005. Megjithatë, aplikimi aktual u paraqit në Gjykatë më 10 nëntor 2006, në një periudhë kohore për më shumë se gjashtë muaj që prej datës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Përprjekjet e pasuksesshme të aplikueses për rishikim të vendimit final nuk mund ta sjellin ankesën brenda limitit kohor gjashtëmujor, siç parashikohet në nenin 35 § 1. Në vijim, rezulton se kërkesa është paraqitur jashtë afatit kohor dhe sipas nenit 35 §§1 dhe 4 të konventës ajo nuk duhet të pranohet.

2. Për sa ka ta bëjë me pretendimin me trajtimin e padrejtë të procedurave të rishikimit

47. Gjykata përsërit faktin se Konventa nuk i detyron shtetet që t’iu ofrojnë individëve mundësinë e rihapjes së çështjes së tyre pasi vendimi është bërë i formës së prerë. Më tej, neni 6 nuk garanton të drejtën për të rihapur procedurat të cilat janë mbyllur nga një vendim i formës së prerë (shiko, midis të tjerëve, Kolu, cituar më sipër; “Schelling kundër Austrisë” (nr.2) (vendim), nr.46128/07, 16 shtator 2010; “Steck-Risch dhe të tjerët kundër Litenshtajnit” (vendim), nr.29061/08, 11 maj 2010; “Mumladze kundër Gjerogjisë”, nr.30097/03, § 35, 8 janar 2008; krahaso “San Leonard Band Club kundër Maltës”, nr.77562/01, §§ 40-48, ECHR 2004-IX). Pas konfirmimit të rihapjes së çështjes, vetëm procedurat e reja mund të merren parasysh për sa ka të bëjë me përcaktimin “e të drejtave civile dhe të detyrimeve” ose të “një akuze penale” (shiko, për shembull, “Aleksyenko kundër Rusisë”, nr.74266/01, § 55, 6 korrik 2009; “Zasurtsev kundër Rusisë”, nr. 67051/01, § 62, 27 prill 2006; “Vanyan kundër Rusisë”, nr.53203/99, § 56, 15 dhjetor 2005; dhe “Kaisti kundër Finlandës” (vendim), nr.70313/01, 14 shtator 2004).

48. Në rastin konkret, kërkesat e aplikueses për rishikim nuk u pranuan nga gjykatat vendase. Për këtë arsye, ato nuk u interesuan për përcaktimin e “të drejtave civile dhe të detyrimeve” apo të një “çështje penale” (shiko “Rudan kundër Kroacisë” (vendim), nr.45943/99, 13 shtator 2001; dhe “Erdemli kundër Turqisë” (vendim), nr.33412/03, 5 shkurt 2004). Kjo pjesë e aplikimit nuk përputhet *ratione materiae* me parashikimet e Konventës dhe duhet të kundërshtohet në bazë të nenit 35 §§3 dhe 4 të Konventës.

3. Për sa ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, të datës 1 korrik 2004

49. Aplikuesja nuk u ankua për moshyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 1 korrik 2004. Megjithatë, Gjykata vendosi me mocionin e saj të bënte me dijeni për këtë çështje qeverinë përkatëse dhe të ekzaminonte ankesën në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

50. Gjykata vëren se më 18 shkurt 2011, Sekretaria i kërkoi aplikueses të konfirmonte nëse vendimi i Gjykatës së Lartë ishte zbatuar. Më 10 mars 2011 aplikuesja informoi me shkrim Gjykatën se ajo e kishte tërhequr shumën që i ishte përcaktuar në një datë të papërcaktuar. Nuk u dorëzuan dokumentet përkatëse, që mbështesin këtë pohim.

51. Për sa ka të bëjë me informacionin në paragrafin e mësipërm, Gjykata shpall vendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 1 korrik 2004 u zbatua në një datë të papërcaktuar. Në mungesë të ndonjë kërkesë tjetër nga ana e aplikueses, Gjykata vendos se kjo ankesë nuk ka baza për t’u diskutuar. Për këtë arsye, ajo duhet të hidhet poshtë, pasi nuk përputhet me nenin 35 §§3 dhe 4 të Konventës.

B. Neni 1 i protokollit nr.1 ankesa

52. Aplikuesja u ankua, *inter alia*, se natyra e padrejtë e proceduarve që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e kontratës së shitjes, ka çuar në shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1. Ajo insiston për t’iu rikthyer hapësira e tokës me sipërfaqe 520 m².

53. Neni 1 i protokollit nr.1 pohon si më poshtë:

“Çdo individ ligjor ka të drejtën për të shijuar i qetë pasuritë e tij. Asnjërit nuk do t’i privohet e drejta e tij për pronësi, vetëm në raste të interesave publikë dhe të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Megjithatë, parashikimet e mësipërme nuk do të dobësojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje të tilla, për aq kohë sa vlerësohet i nevojshëm kontrolli mbi përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve të tjera ose të dëmeve”.

54. Në bazë të vendimeve në paragrafët e mësipërm 41-46, Gjykata vendos se ankesa është dorëzuar jashtë afatit dhe sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, ajo nuk mund të pranohet.



Për këto arsye, Gjykata e deklaron unanimitisht aplikimin të papranueshëm.

Lawrence Early
Sekretar

Lech Garlicki
President

SEKSIONI I KATËRT
ANKIMI NR.29975/06

VENDIM
NGA BESNIK SHARRA
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), më 6 dhjetor 2011, në cilësinë e një dhome të përbërë nga:

Lech Garlicki, Kryetar

David Thór Björgvinsson

George Nicolaou

Ledi Bianku

Zdravka Kalaydjieva

Nebojša Vučinić

Vincent A. De Gaetano, gjyqtarë,

dhe Fatoş Araci, zëvendësregjistruer i seksionit,

duke marrë në konsideratë ankimin e mësipërm të depozituar më 19 korrik 2006,

duke marrë në konsideratë vëzhgimet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre, të paraqitura nga ankuesi,

Pas shqyrtimit të tyre, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Ankuesi, z. Besnik Sharra, është një shtetas belg, i cili ka lindur në 1959 dhe banon në Bruksel. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga z. A. Hajdari, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria e Shqipërisë (Qeveria) u përfaqësua nga agentët e saj në atë kohë, znj. S. Mëneri dhe znj. E. Hajro.

Faktet e çështjes, të parashtruara nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

A. Procedimet në lidhje me kompensimin e parave të ankuesit

2. Më 7 shtator 1995, ankuesi lidhi një kontratë huaje me një shoqëri private, UCMK, nëpërmjet njërit prej aksionarëve të saj, G.M. Ai ra dakord të jepte hua shumë 250,000 dollarë amerikanë nga data 7 shtator 1995 deri në 7 dhjetor 1995, me normë interesi gjashtë për qind në muaj. Kur shoqëria nuk e përmbushi detyrimin financiar, ankuesi ngriti një padi në Gjykatën e Rrethit, Vlorë, për kompensimin e borxhit sipas kontratës së huasë.

3. Më 13 gusht 1996, Gjykata e Rrethit, Vlorë, (Gjykata e Rrethit) urdhëroi UCMK-në, e cila u përfaqësua nga G.M, që të shlyente shumë e principalit, duke përfshirë interesin e shtuar. Në mungesë të një ankimi, vendimi i Gjykatës së Rrethit mori formë të prerë dhe u bë i zbatueshëm.

4. Një urdhër ekzekutimi u lëshua për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit më 3 shtator 1996, si rezultat i të cilit prona e UCMK-së, një fabrikë për prodhimin e llambave, u sekuestrua nga Zyra e Përmbarrimit, Vlorë. Nuk ka informacion në lidhje me zhvillimet e procedimeve pas sekuestrimit.

5. Në një datë të papërcaktuar në fillim të vitit 1997, ankuesi u largua nga vendi dhe iu dha azil politik në Belgjikë. Ai nuk u kthye në Shqipëri deri në 2002.

B. Procedimet e falimentimit kundër shoqërisë private

6. Me kërkesë të aksionarëve të UCMK-së që kishin dorëzuar regjistrin më 29 shtator 1998, më 3 mars 1998 Gjykata e Rrethit shpalli hapjen e procedimeve në lidhje me UCMK-në. Duke marrë parasysh raportet dhe inspektimet e kryera nga asambleja e përgjithshme e kreditorëve, gjykata vendosi që asnjë plan riorganizimi nuk mund të konsiderohej i realizueshëm, pasi shoqëria nuk kishte mjete financiare me anë të të cilave të përmbushte kërkesat e kreditorëve të saj.

7. Me vendimin e datës 17 prill 1998, Gjykata e Rrethit miratoi listën e kreditorëve të përgatitur nga asambleja e kreditorëve, duke përfshirë shumat e papaguara të kërkueshme. Rezultoi që aksionarët e UCMK-së kishin fshirë emrin e ankuesit nga lista e kreditorëve që ia kishin paraqitur Gjykatës së Rrethit sipas seksionit 6 të ligjit për falimentimin të vitit 1995. Si rrjedhojë, emri i ankuesit nuk u përfshi në listën e kreditorëve të miratuar nga Gjykata e Rrethit.

8. Më tej, Gjykata e Rrethit shpalli falimentimin e shoqërisë dhe i njohu kreditorët si aksionarë të pronave të saj. Ajo caktoi një administrator, i cili, së bashku me kreditorët, duhet të procedonte me vlerësimin e pronave të shoqërisë.

C. Zbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit i datës 13 gusht 1996

9. Në vitin 2002, ankuesi u kthye në Shqipëri për një vizitë dhe kërkoi informacione rreth zbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit. Ai u informua se asnjë nga pronat e UCMK-së nuk ishte sekuestruar në emër të tij dhe për rrjedhojë, vendimi i vitit 1996 nuk ishte zbatuar. Ankuesi u kthye në Belgjikë në një datë të papërcaktuar pa ndërmarrë asnjë veprim.

10. Në vitin 2005, ankuesi u kthye në Shqipëri dhe më 5 shtator depozitoi një kërkesë për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit.

11. Më 6 tetor 2005, zyra e përmbartimit urdhëroi sekuestrimin e pronës së G.M-së, pa e përcaktuar atë.

12. Më 13 tetor 2005, prona e UCMK-së, fabrika për prodhimin e llambave, u sekuestrua.

13. Më 23 nëntor 2005 zyra e përmbartimit u përpoq të shiste në një ankand publik fabrikën për prodhimin e llambave. Rezulton se zyra e përmbartimit nuk ishte në dijeni të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 17 prill 1998 në lidhje me falimentimin e shoqërisë dhe emërimin e një administratori.

14. Më 23 dhjetor 2005 një avokat dërgoi një shkresë pranë autoriteteve tatimore, Vlorë, me të cilën kërkonte informacione rreth regjistrimit të UCMK-së si subjekt tregtar. Një shënim me shkrim dore në pjesën e poshtme të djathtë tregoi se kjo shoqëri nuk ishte regjistruar pranë autoriteteve tatimore.

D. Padia e administratorit për rivendosje në afatin e ankimit

15. Në një datë të papërcaktuar, administratori depozitoi një ankim në Gjykatën e Rrethit, Vlorë, ku kërkonte rivendosje në afatin e ankimit, për t'i dhënë atij mundësinë të kundërshtonte vendimin e Gjykatës së Rrethit të 13 gushtit 1996. Administratori pohoi se nuk kishte qenë në dijeni të atij vendimi gjykate ose të faktit që ankuesi ishte një prej kreditorëve të UCMK-së, pasi emri i ankuesit nuk përfshihej në listën e kreditorëve të përgatitur nga aksionarët e UCMK-së.

16. Me një vendim të datës 30 mars 2006, Gjykata e Rrethit miratoi padinë e administratorit për rivendosje në afatin e ankimit, në përputhje me seksionin 16 § 2 të ligjit për falimentimin të vitit 1995. Pas fletëthirrjes fillestare për të marrë pjesë në procedime, Gjykata e Rrethit vazhdoi procesin në mungesë të ankuesit, sipas nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile (KPP) pasi ai nuk ishte banues



në Shqipëri. Ankuesi u informua për vendimin në një datë të papërcaktuar në 2006 dhe pretendoi se në atë kohë kishin përfunduar të gjitha afatet kohore për paraqitjen e një ankimi.

17. Më 16 maj 2006, zyra e përmbarimit vendosi të ndërpriste zbatimin e urdhrin të ekzekutimit të 3 shtatorit 1996, me arsyetimin se lejimi i rivendosjes në afatin e ankimit në favor të administratorit, e kishte zhveshur vendimin e Gjykatës së Rrethit të vitit 1996 nga efekti i tij *res judicata*. Zyra e përmbarimit përcaktoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit i vitit 1996 nuk përbënte titull të zbatueshëm sipas Kodit të Procedurës Civile.

E. Procedimet e rigjykimit

18. Më 12 prill 2006, administratori depozitoi një ankim në Gjykatën e Apelit, Vlorë (Gjykata e Apelit), duke pretenduar se kishte pasur parregullsi serioze procedurale në procedime, të cilat kishin çuar në vendimin e gjykatës të vitit 1996.

19. Pa pasur mundësinë e përcaktimit të vendndodhjes së ankuesit, me qëllim thirrjen e tij në gjykim, më 2 mars 2007 Gjykata e Apelit nxori një njoftim publik për seancën e 30 marsit 2007, sipas nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Më 30 mars 2007, Gjykata e Apelit vendosi të rrëzonte vendimin e Gjykatës së Rrethit të 18 marsit 1996 për shkak të parregullsive serioze procedurale. Ajo konstatoi se Gjykata e Rrethit nuk kishte arritur të njoftonte dhe të thërriste dy aksionarët e tjerë të shoqërisë. Në fund ajo dërgoi çështjen për rigjykim. Pjesët përkatëse të vendimit parashikojnë si më poshtë.

“Duke mos përcaktuar siç duhet palët e procedimit dhe duke mos njoftuar palët për kohën dhe datën e seancës, shqyrtimi i kësaj çështjeje ishte në shkelje të rëndë të rregullave procedurale dhe nuk respektoi dispozitat e nenit 467 (ç) dhe (d) të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë filloi shqyrtimin e çështjes pa njoftuar të paditurin [pra, shoqërinë]. Ajo gaboi në përcaktimin e palëve të procedimit pasi nuk arriti të sigurote prova të rëndësishme, si për shembull statutin e [shoqërisë], nenet e themelimit dhe vendimin e gjykatës, në bazë të të cilave mund të kishte zbuluar cilin të thërriste në seancë dhe adresën e saktë të selisë së shoqërisë. Gjykata thirri vetëm G.M, i cili ishte një prej aksionarëve. Në dosjen e çështjes nuk kishte prova që ai ishte autorizuar ose kishte prerogativë tjetër për të përfaqësuar shoqërinë ose për të kryer veprime në emër të saj.”

21. Më 21 qershor 2007, Gjykata e Apelit nxori një njoftim publik që shpallte rezultatin e vendimit të saj.

22. Pas tre përpjekjeve të pasuksesshme për të thirrur ankuesin në seancë, më 19 nëntor 2007 Gjykata e Rrethit nxori një njoftim publik për të informuar ankuesin në lidhje me seancën e 3 dhjetorit 2007, sipas nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile.

23. Më 3 dhjetor 2007, në mungesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit vendosi të mbyllte procedimet në përputhje me nenin 179 §1 të Kodit të Procedurës Civile.

F. Veprimet e administratorit për ndjekjen penale të GM-së

24. Më 9 mars 2006, administratori i kërkoi prokurorisë fillimin e procedimit penal kundër GM-së për veprën penale të hartimit të deklaratave të rreme, duke marrë parasysh informacionin e pasaktë që ai kishte paraqitur gjatë procedimeve të falimentimit (shihni paragrafin 7 më sipër).

25. Më 13 mars 2006, prokuroria rrëzoi kërkesën me argumentimin e parashkrimit dhe Ligjit për Amnistinë të vitit 2002.

G. Përjashtimi i Shqipërisë nga detyrimet e saj sipas Konventës

26. Me notën verbale të 4 marsit 1997, e cila u regjistrua pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 10 mars 1997, Ministria shqiptare e Punëve të Jashtme, në përputhje me nenin 15 të Konventës, informoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi synimin e Qeverisë për t'u

përrjashtuar nga detyrimet e saj sipas Konventës. Pjesët përkatëse të notës verbale janë si më poshtë (të nxjerra nga origjinali në gjuhën angleze).

I. Në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.7491 të datës 29.4.1991 “Mbi dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Qeverisë, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë mori vendimin për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Kjo situatë do të jetë e përgjithshme, duke mbuluar të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo filloi nga data 2 mars 1997 në orën 17.35 dhe do të vazhdojë deri në momentin e rivendosjes së plotë të rendit kushtetues dhe publik.

II. Vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme u imponua për shkak të situatës së pazakontë të krijuar gjatë ditëve të fundit në Shqipëri. Disa forca, duke shfrytëzuar protestat dhe dëshpërimin e qytetarëve, të cilët humbën paratë e tyre nga dështimi i skemave financiare piramidale, organizuan terroristë që të kryenin veprime të dhunshme. Pa organizimin e grumbullimeve paqësore, këto grupe shkelën ligjin, rendin kushtetues, jetën e qytetarëve, institucionet dhe integritetin territorial të vendit, duke krijuar kështu kushte për ta përfshirë Shqipërinë në një luftë civile. Të përballura me këto sulme dhune ekstreme, forcat policore kanë ruajtur vetëkontrollin, duke marrë vetëm pozicione mbrojtëse dhe duke mos përdorur armë zjarri, gjë që shmangu një konflikt të mundshëm me pasoja të paparashikueshme. Disa ditë më vonë situata u bë tejet e ndërlikuar dhe arriti kulmin në momentin e diskutimit të vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme.

Megjithëse Qeveria bëri një propozim, Kuvendi Popullor, me ndërhyrjen e Presidentit të Republikës, pas një diskutimi të gjerë dhe publik refuzoi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe urdhëroi vendosjen e përkohshme të disa trupave ushtarake për të ndihmuar forcat policore. Me synim dialogun dhe në pritje të reagimit të protestuesve, Qeveria dha dorëheqjen.

Më 1 mars 1997, një rebelim i armatosur komunist shpërtheu në Vlorë dhe rajonet e afërme, i organizuar nga ish-komunistët shqiptarë dhe ish-policia sekrete shqiptare, në bashkëpunim me shërbime të fshehta të huaja. Grupe terroriste sulmuan qytetet jugore për të marrë pushtetin me forcën e armëve. Synimi i sulmeve të tyre ishin njerëz të pafajshëm, bashki dhe komisarariatet e policisë; burgjet shpërthyen dhe kriminelë dhe vrasës ordinerë u armatosën, qindra e mijëra miliona lekë u vodhën nga bankat; shtëpitë e qytetarëve dhe dyqanet e biznesmenëve u sulmuan. Qëllimi i qartë ishte terrorizimi i popullsisë për të paralizuar dhe marrë pushtetin me forcë.

...

IV. Sipas ligjit nr.8194 të datës 2.3.1997 “Për gjendjen e jashtëzakonshme në raste shkeljesh të rënda të rendit kushtetues dhe publik”, në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme duhet të krijohet një regjim i masave të veçanta. Këshilli i Mbrojtjes drejtoi të gjithë aktivitetin shtetëror që synonte të trajtonte gjendjen e jashtëzakonshme. Nën gjendjen e jashtëzakonshme, Republika e Shqipërisë mori disa masa që përjashtonin detyrimet e saj ndërkombëtare. Këto përjashtime bëhen në masën rreptësisht të kërkuar nga situata, jo në mospërputhje me të drejtën tonë kushtetuese “Mbi dispozitat kryesore kushtetuese”, as me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shteti Shqiptar është palë, veçanërisht “Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe “Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike”. Ato u bënë vetëm për një periudhë të kufizuar kohore. Këto përjashtime përfshijnë kufizimin e disa të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të individëve. Në lidhje me këtë çështje, neni 41 i ligjit nr.7692 i datës 31.3.1993 “Mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore” parashikon se “Ushtrimi i disa të drejtave specifike mund të kufizohet përkohësisht me ligj në një situatë emergjence kombëtare ose luftime, me përjashtim të të drejtave të parashikuara në nenin 1 (e drejta për jetën)...3 (heqja e torturës), 6 (mosshtrëngimi për të pohuar fajin), 19 (liria e ndërgjegjes dhe fesë), 25 (barazia përpara ligjit), 39 (kthimi gjyqësor i të drejtës) dhe 40 (garantimi i një gjykimi të drejtë)”.



Sipas ligjit nr.8194 të datës 2.3.1997 “Për gjendjen e jashtëzakonshme në raste shkeljesh të rënda të rendit kushtetues dhe publik”, si dhe ligjit “Për disa masa në kontekstin e gjendjes së jashtëzakonshme”, kufizimet specifike në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të cilat rrjedhin nga këto përjashtime nga detyrimet tona ligjore ndërkombëtare, janë si më poshtë:

1. Të gjithë rebelët e armatosur duhet të dorëzojnë armët, municionet dhe lëndët plasëse më 3 mars 1997, në orën 14. Pas këtij afati, rebelët e armatosur në fushën e betejës do të qëllohen pa paralajmërim (neni 1).

2. Ndalohen të gjitha grumbullimet në vendet publike (neni 6)

3. Ndalohen të gjitha aktivitetet e natyrës politike, sportive, kulturore ose tregtare (neni 6).

4. Lëvizja e lirë e njerëzve ndalohet gjatë orëve të caktuara të ditës (nga ora 20 deri në orën 7) (neni 7).

5. Grumbullimet e paligjshme në vende publike duhet të shpërndahen. Në rast se është e pamundur që kjo shpërndarje të bëhet me mjete të tjera, njësitë policore janë të autorizuar të përdorin gaz lotsjellës, si dhe armë zjarri, në masën e nevojshme që të kryejnë detyrën e tyre sipas ligjit (neni 6).

6. Vendosen kufij në lirinë e shtypit dhe informacionit. Ndalohet publikimi dhe shpërndarja në shtyp dhe transmetimet në radio të raporteve që provokojnë dhe shkaktojnë veprime të dhunshme kundër sigurisë kombëtare, rendit kushtetues, sigurisë publike dhe jetës së individit. Shtypi dhe media e përditshme janë të detyruara të publikojnë tekstin e plotë të raporteve zyrtare që janë të lidhura drejtpërdrejt me gjendjen e jashtëzakonshme. Organet e shtypit janë të detyruara të marrin miratim, përpara shitjes, të materialit që synohet të publikohet, nga personeli lokal përgjegjës për ekzekutimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Personeli lokal ka të drejtë të pezullojë çdo publikim që shkel këtë dispozitë (neni 4).

...”

27. Me *notën verbale* të 26 korrikut 1997, e cila u depozitua pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 24 tetor 1997, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme informoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se Qeveria po tërhiqte njoftimin e tyre të përjashtimit sipas nenit 15 të Konventës. Pjesët përkatëse të *notës verbale* janë si më poshtë.

“Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplimentet e saj Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe duke iu referuar përmbajtjes së nenit 15.3 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ka nderin ta informojë se Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, me miratimin e ligjit nr.8225 të 24 korrikut 1997 “Mbi heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Shqipërisë”, vendosi t’i jepte fund gjendjes së jashtëzakonshme në të gjithë territorin e vendit. Që nga ajo datë të gjitha masat e marra në zbatim të gjendjes së jashtëzakonshme kanë pushuar së pasuri efekt”.

H. E drejta dhe praktika përkatëse e brendshme

I. Kushtetuta

28. Pjesët përkatëse të Kushtetutës Shqiptare parashikojnë si më poshtë.

“Neni 142 § 3”

Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

2. Praktika përkatëse e Gjykatës Kushtetuese

29. Praktika përkatëse e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shkeljen e të drejtës së një ankuesi për akses në gjykatë për shkak të moszbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë, përshkruhet hollësisht në çështjen Gjyli kundër Shqipërisë, nr.32907/07, §§21-27, 29 shtator 2009.

3. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

30. Pjesët përkatëse të KPC-së parashikojnë si më poshtë.

Neni 133

Kur marrësit [të fletëthirrjes] nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij..., ai do të njoftohet për [seancën] nëpërmjet afishimit të kopjes së dokumentit në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit ku ka pasur vendbanimin e fundit dhe kur ky nuk dihet, në atë të vendit të tij të lindjes.

Në rast se Shqipëria ka lidhur marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, dispozita e lartpërmendur zbatohet vetëm në masën kur njoftimi nuk është i mundur në një prej mënyrave të parashikuara në ato marrëveshje.”

Neni 179 - Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve

“Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten si në veprimet përgatitore, ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit.

...”

Neni 192-Thirrja e personit të tretë

Secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohej një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.

...

Thirrja e personit të tretë lejohet kur ai ka banim të ditur brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe derisa nuk ka përfunduar gjykimi i çështjes në shkallë të parë.

Neni 458- Rivendosja në afatin e ankimit

Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin..”

Neni 467- Dërgimi për rigjykim

Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

....

ç) çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit;

d) nuk është formuar drejt ndërgjyqësia;

...”

Neni 510- Titujt ekzekutivë

“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë

....

a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës...”

Neni 511-Urdhri i ekzekutimit

“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, i cili jepet:

a) për rastet e parashikuara nga shkronja “a” e nenit të mësipërm, nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Neni 515- Vënia në ekzekutim

“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi i përmbarimor gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”



Neni 560- Vënia e sekuestros

“Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo titujve të tjerë ekzekutivë mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestros mbi to.

Sekuestroja vihet me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të aktit të përmbauesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe [një përshkrim] të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendndodhja e tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të.

Një kopje e aktit të përmbauesit gjyqësor i komunikohet debitorit.”

Neni 567- Procedura e shitjes në ankand

“Pas vënies së sekuestros, përmbauesi gjyqësor i dërgon njoftim debitorit se sendi i sekuestruar do të shitet [në ankand], në qoftë se brenda 10 ditëve të njoftimit ai nuk e përmbush detyrimin...”

Neni 568

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbauesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm...”

Neni 610-Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor

“Kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit apo refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur edhe në raste të tjera nga dita që i është njoftuar ose ka marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.”

Neni 617-Ankimi kundër pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit

“Pezullimi i ekzekutimit, përveç rastit kur vendoset nga gjykata, si dhe pushimi i ekzekutimit vendosen nga përmbauesi gjyqësor.

Kundër këtyre vendimeve mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë...”

4. *Ligji për falimentimin i vitit 1995 (ligji për procedurat e falimentimit, nr.8017, i datës 25 tetor 1995)*

31. Ligji për falimentimin i vitit 1995, në fuqi në kohën fizike, parashikonte se procedimet e falimentimit duhet të kryheshin në gjykatë (seksioni 3). Nëse procedimet do të fillonin me argumentimin e një padie ligjore nga kreditori, nuk do të ishte e nevojshme që ai të provonte se debitori nuk e kishte kryer pagesën. Në çdo rast, debitori mund të ngrinte edhe një padi të ngjashme (seksioni 5).

32. Gjatë procedimeve gjykata mund të merrte në pyetje dëshmitarët, të thërriste ekspertë dhe të dëgjonte provat nga debitori (seksionet 5 dhe 7), i cili ishte i detyruar t'i paraqiste gjykatës, *ndër të tjera*, një listë të saktë të të gjitha pronave të tij dhe vlerën e tyre përkatëse, një listë të kreditorëve me emrat dhe adresat e tyre dhe detyrimin ndaj secilit prej tyre, si dhe një listë të debitorëve me shumat përkatëse që ata i detyroheshin atij. Debitori iu nënshtrua përgjegjësisë penale për vërtetësinë e listave (seksioni 6).

33. Procedimet e falimentimit filluan në bazë të një vendimi gjykate, i cili *ndër të tjera*, do të përcaktonte një afat brenda të cilit të gjithë kreditorët mund të paraqisnin kërkesat e tyre dhe shumat përkatëse në lekë shqiptare, të deklarorin arsyet që shkaktuan pjesëmarrjen e tyre në procedimet e falimentimit, si dhe të jepnin pëlqimin për shpërndarjen e shumave të përftuara nga procedimet e falimentimit (seksioni 9). Gjithashtu, gjykata e rrethit do të merrte vendim ta vendoste debitorin nën administrim të detyrueshëm, me anë të emërimit të një administratori.

34. Në bazë të fillimit të procedimeve të falimentimit, debitori humbi të drejtën për të zotëruar dhe administruar të gjitha pronat e tij të tashme dhe të ardhshme. Çdo procedim civil dhe arbitrazhi, në të cilin debitori ishte palë, u pezullua me fillimin e procedimeve të falimentimit.

Vendimet gjyqësore të dhëna përpara fillimit të procedimeve të falimentimit në lidhje me zbatimin e një vendimi gjyqësor nuk ishin më detyruese me fillimin e procedimeve të falimentimit (seksioni 11).

35. Gjatë përmbushjes së detyrave të tij, administratori vepronte nën mbikëqyrjen e gjykatës, e cila kishte të drejtën për ta zëvendësuar atë, duke deklaruar arsyet përkatëse (seksioni 14). Në përputhje me seksionin 16, administratori mund të depozitonte një padi civile kundër padive ligjore të debitorit, në rast se debitori do të kishte përkeqësuar qëllimisht pozicionin e një prej kreditorëve dhe kur kjo iu bë e ditur palës së tretë, ose nëse, në vitin përpara fillimit të procedimeve të falimentimit, debitori do të kishte përkeqësuar qëllimisht pozicionin e [kreditorit] në favor të personave të tjerë, në masën që kjo mund të provohet dhe në masën që administratori nuk ishte në dijeni të dëmit të pësuar.

36. Ligji për falimentimin i vitit 1995 parashikonte mundësinë e hartimit të një plani riorganizimi, me synim likuidimin përfundimtar të debitorit. Ky plan kërkonte miratimin e gjykatës (seksioni 26-32). Më pas, administratori procedoi me likuidimin e debitorit dhe shpërndarjen e shumave të mbledhura për kreditorët, në përputhje me tabelën e detyrimeve të papaguara që ishte miratuar nga gjykata (seksioni 32).

37. Ligji për falimentimin i vitit 1995 u shfuqizua me ligjin nr.8901 të datës 23 mars 2002.

ANKIMET

38. Ankuesi u ankua se vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 30 mars 2007 në të vërtetë kishte rrëzuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit, të datës 13 gusht 1996 dhe shkelte parimin e sigurisë juridike sipas nenit 6§1 të Konventës. Më tej, ai u ankua se autoritetet nuk kishin arritur të zbatonin brenda një afati të arsyeshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit të 13 gushtit 1996. Ai pretendoi se procedimet e rigjyqimit kishin qenë të padrejta.

39. Më tej, ankuesi u ankua sipas nenit 1 të protokollit nr.1, se nuk kishte pasur mundësinë për kompensimin e parave që i ishin dhënë në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 13 gusht 1996.

E DREJTA

A. Ankimet sipas nenit 6§1 të Konventës

40. Ankuesi paraqiti tre ankime kryesore sipas nenit 6 të Konventës, pra, se kishte pasur një shkelje të parimit të sigurisë juridike, se një vendim gjykate i formës së prerë në favorin e tij nuk ishte zbatuar dhe se procedimet e rigjyqimit kishin qenë të padrejta. neni 6 § 1 i Konventës, në masën që lidhet me çështjen, parashikon si më poshtë.

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile...çdokush ka të drejtën e një gjykimi ...të drejtë brenda një afati kohor të arsyeshëm nga [një] gjykatë...”

1. Shkelja e pretenduar e parimit të sigurisë juridike

a. Parashtrimet e palëve

41. Qeveria parashitroi se autoritetet kishin paraqitur arsyetime të drejta në rrëzimin e një vendimi detyrues dhe të formës së prerë.

42. Ankuesi u ankua se autoritetet kishin rrëzuar vendimin e formës së prerë të datës 13 gusht 1996 pas njëmbëdhjetë vjetësh. Ai pretendoi se vendimi i Gjykatës së Apelit i 30 marsit 2007 kishte qenë arbitrar për faktin se gjykata kishte gabuar në vlerësimin e fakteve. Ai pohoi se në 1996 shoqëria ishte përfaqësuar sipas rregullave nga G.M.

43. Sipas mendimit të ankuesit, autoritetet e brendshme kishin nxjerrë vendime çorientuese dhe kontradiktore, të cilat shkaktuan një situatë pasigurie juridike. Ata nuk kishin mundur të siguronin të drejtat e tij sipas Konventës.



b) Vlerësimi i Gjykatës

44. Gjykata rithekson se e drejta për një gjykim të drejtë pranë një gjykate, e garantuar nga neni 6§1 i Konventës, duhet të interpretohet duke marrë parasysh parathënien e Konventës që deklaron në pjesën e saj përkatëse se shteti ligjor duhet të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një prej aspekteve themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili ndër të tjera, kërkon që kur gjykatat të kenë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim (*shihni Brumarescu kundër Rumanisë, 28 tetor 1999, § 61, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1999-VII*).

45. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rihapje të procedimeve vetëm për qëllim të sigurimit të një rigjykimi dhe vendimi të ri për çështjen. Kompetenca e gjykatave më të larta për të rrëzuar ose ndryshuar vendimet gjyqësore detyruese dhe të zbatueshme duhet të ushtrohet për qëllim të korigjimit të të metave kryesore. Vetëm mundësia e dy pikëpamjeve për subjektin nuk përbën arsye për rishqyrtim. Përgjashtimet nga ky parim justifikohen vetëm kur bëhen të nevojshme nga rrethanat e një natyre thelbësore dhe detyruese (*shihni mutatis mutandis, "Ryabykh kundër Rusisë", nr.52854/99, § 52, ECHR 2003-X dhe "Pravednaya kundër Rusisë", nr.69529/01, § 25, 18 nëntor 2004*).

46. Gjykata vëren se vendimi i formës së prerë i 13 gushtit 1996 në favor të ankuesit u anulua me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 marsit 2007. Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rastin në fjalë, rrëzimi i vendimit të formës së prerë në favor të ankuesit ishte justifikuar sipas rrethanave dhe nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesave të ankuesit dhe nevojës për të garantuar administrimin e duhur të drejtësisë.

47. Gjykata vëren se në çështjen në fjalë, Gjykata e Apelit nuk e bazonte vlerësimin e saj për rrëzimin e vendimit të 13 gushtit 1996 në një kërkesë të gabuar ose interpretim të ligjit material nga gjykatat më të ulta (krahasoni, për shembull, "*Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë*", nr.2141/03, §§52-60, 24 mars 2009 dhe "*Driza kundër Shqipërisë*", nr.33771/02, §§63-71, ECHR 2007-XII (ekstrakte)).

48. Më parë gjykata konstatoi se një e metë kryesore në procedime, si për shembull, veçanërisht një gabim juridiksional, shkelje të rënda të procedurës gjyqësore, shpërdorimi i detyrës, gabime të dukshme në zbatimin e ligjit material ose arsye të tjera thelbësore që rrjedhin nga interesat e drejtësisë, në parim mund të justifikonin një devijim nga parimi i sigurisë juridike (*shihni, në kontekstin e procedimeve civile, "Tolstobrov kundër Rusisë", nr.11612/05, §§17-20, 4 mars 2010; "Tishkevich kundër Rusisë", nr.2202/05, §§23-27, 4 dhjetor 2008; "Protsenko kundër Rusisë", nr.13151/04, §§25-34, 31 korrik 2008, dhe "Luchkina kundër Rusisë", nr.3548/04, § 21, 10 prill 2008; në kontekstin e procedimeve ligjore, shihni "Lenskaya kundër Rusisë", nr.28730/03, §§ 36-44, 29 janar 2009; "Fadin kundër Rusisë", nr.58079/00, §§ 33-36, 27 korrik 2006, "Radchikov kundër Rusisë", nr.65582/01, § 48, 24 maj 2007; dhe "Bratyakin kundër Rusisë" (dhjetor), nr.72776/01, 14 prill 2001. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit konstatoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit ishte dhënë në shkelje të rëndë të ligjit procedural. Gjykata e Rrethit nuk kishte shqyrtuar nëse G.M ishte i autorizuar të përfaqësonte shoqërinë ose të vepronte në emër të saj dhe nëse të paditur të tjerë ishin identifikuar dhe thirrur sipas rregullave në procedime. Ky mosveprim ishte i një natyre serioze dhe i ngjashëm me mosveprimet që kishin zbuluar më parë shkelje të parimit të një gjykimi të drejtë (*shihni Tishkevich, të cituar më lart, § 25*).*

49. Gjykata vëren se administratori u vu në dijeni për vendimin e 13 gushtit 1996 shumë më parë se ai të merrte formë të prerë. Ai nuk ishte njoftuar për ekzistencën e këtij vendimi jo për faj të tij. Me qëllim mbrojtjen e interesave të kreditorëve të shoqërisë së debitorit, lista e të cilëve ishte përfunduar në bazë të vendimit të falimentimit të 17 prillit 1998, ai vendosi të kundërshtonte vendimin në favor të ankuesit. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe seksionit 11 të ligjit të

falimentimit të vitit 1995, i cili pengonte zbatimin e një vendimi gjykate të formës së prerë të dhënë përpara fillimit të procedimeve të falimentimit kundër debitorit.

50. Në masën që ankuesi argumenton se Gjykata e Apelit nuk i kishte vlerësuar si duhet faktet, Gjykata rithekson se pranueshmëria e provave është kryesisht një çështje që duhet të rregullohet nga ligji kombëtar dhe se, si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat e paraqitura para tyre. Sipas Konventës, detyra e Gjykatës është më tepër të konstatojë nëse procedimet, në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat, ishin të drejta (shihni “*Elsholz kundër Gjermanisë*” [GC], nr.25735/94, § 66, ECHR 2000-VIII).

51. Në këtë kontekst, pas ankimit të administratorit të datës 12 prill 2006, ankuesi u thirr për të marrë pjesë në seancën e 30 marsit 2007, Megjithatë, ai nuk mund të gjurmohej. Gjykatat e brendshme morën masa të mëtejshme duke nxjerrë njoftime publike për të njoftuar ankuesin në lidhje me seancën. Kur ankuesi nuk mundi të merrte pjesë në seancë, ata proceduan në mungesë. Gjykata konstaton se gjykatat e brendshme vepruan në përputhje me të drejtën e brendshme dhe bënë çfarë pritej në mënyrë të arsyeshme prej tyre, duke i dhënë ankuesit garancitë procedurale të nenit 6 § 1 të Konventës. Ankuesit nuk arritën të përcaktonin ndonjë mungesë tjetër të garancisë procedurale.

52. Sa më sipër, Gjykata çmon se rrethanat e përmendura ishin në natyrën dhe rëndësinë e tyre, të tilla që justifikonin rrëzimin e vendimit të formës së prerë dhe se kjo nuk ishte në përputhje me parimin e sigurisë juridike.

53. Rezulton se ky ankim është haptazi i pabazuar sipas nenit 35 § 3 dhe rrjedhimisht i papranueshëm në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

2. Pretendimi i moszbatimit të vonuar i vendimit të Gjykatës së Rrethit i 13 gushtit 1996

a) Parashtrimet e palëve

54. Qeveria parashtrroi se nuk kishte pasur shkelje të të drejtave të ankuesit për tre arsye. Fillimisht, zbatimi i vendimit të 13 gushtit 1996 u pengua nga kriza e vitit 1997 që kishte ndikuar negativisht në administrimin e duhur të drejtësisë dhe sistemin e përmbarimit në Shqipëri. Së dyti, sipas mendimit të tyre, vendimi i gjykatës i formës së prerë nuk mund të zbatohet, duke marrë parasysh procedimet e falimentimit që ishin paraqitur kundër shoqërisë debitore. Qeveria argumentoi se ankuesi nuk mund të kishte pritur në mënyrë të ligjshme, që vendimi i formës së prerë i gjykatës të zbatohet pasi të ishte shpallur falimentimi i shoqërisë debitore. Së treti, Qeveria argumentoi se zyra e përmbarimit kishte marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, për shembull, duke sekuestruar pronat e shoqërisë së debitorit.

55. Ankuesi parashtrroi se deri tani vendimi i 13 gushtit 1996 nuk ishte zbatuar. Ndërsa zyra e përmbarimit kishte filluar ekzekutimin e tij më 3 shtator 1996, që nga ajo datë nuk ishte marrë asnjë masë deri më 3 mars 1998, kur u shpall falimentimi i shoqërisë. Ankuesi pretendoi se Qeveria nuk ishte përjashtuar nga detyrimet për të respektuar të drejtat individuale sipas nenit 15 të Konventës.

56. Ankuesi pohoi se ekzekutimi i vendimit të gjykatës në favor të tij nuk ishte i një natyre të ndërlikuar. Gjithçka që zyra e përmbarimit duhet të bënte ishte që të sekuestronte pronat e shoqërisë dhe t'i shiste në një ankand. Sipas mendimit të tij, Qeveria nuk kishte arritur të paraqiste justifikime për pamundësinë e autoriteteve për të zbatuar vendimin e 13 gushtit 1996.

b) Vlerësimi i Gjykatës

57. Gjykata vëren fillimisht se kur një ankues ankohet rreth moszbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë në favorin e tij ose të saj, masa e detyrimeve të Shtetit sipas nenit 6 ndryshon në varësi të faktit nëse debitori është një Palë e Lartë Kontraktuese, sipas nenit 34 të Konventës ose një personi privat. Në rastin e mëparshëm, praktika e Gjykatës zakonisht vë theksin mbi shtetin që ekzekuton vendimin përkatës të gjykatës si plotësisht, edhe në kohën e duhur (shihni për shembull *Burdov kundër Rusisë*, nr.59498/00 §§ 33-42, ECHR 2002-III). Kur debitori është



person privat, pozicioni është i ndryshëm pasi Shteti, si rregull i përgjithshëm, nuk është drejtpërdrejt përgjegjës për borxhet e personave privatë dhe detyrimet e tij sipas dispozitave përkatëse të Konventës kufizohen në ofrimin e ndihmës së nevojshme për kreditorin për zbatimin e vendimeve përkatëse të gjykatës, për shembull, nëpërmjet një shërbimi përmbartimor ose procedurave të falimentimit (shihni, për shembull, “*Shestakov kundër Ruisisë*” (dhjetor), nr.48757/99, 18 qershor 2002; “*Krivotogova kundër Ruisisë*” (dhjetor), nr.74694/01, 1 prill 2004; dhe “*Kesyan kundër Ruisisë*”, nr.36496/02, 19 tetor 2006). Kështu, kur autoritetet janë të detyruara të veprojnë, me qëllim zbatimin e një vendimi të formës së prerë dhe ato nuk arrijnë të veprojnë në këtë mënyrë, mosveprimtaria e tyre, në rrethana të caktuara, mund të përfshijë përgjegjësinë e Shtetit sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1 (shihni “*Scollo kundër Italisë*”, 28 shtator 1995, §44, seria A nr.315-C, dhe “*Fuklev kundër Ukrainës*”, nr.71186/01, § 84, 7 qershor 2005).

58. Në çështjen në fjalë, ankuesi lidhi një marrëveshje huaje me një shoqëri private. Pas mospërbushjes së detyrimeve të shoqërisë, më 13 gusht 1996 Gjykata e Rrethit konstatoi në favorin e ankuesit dhe urdhëroi kompensimin e parave nga shoqëria. Gjykata do të shqyrtojë nëse masat e zbatuara nga autoritetet ishin të mjaftueshme dhe nëse ata vepruan me kujdes, me qëllim që ta ndihmonin ankuesin për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të vitit 1996 (shihni “*Fociac kundër Rumanisë*”, nr.2577/02, §70, 3 shkurt 2005, dhe *Fuklev*, të cituara më lart, § 84).

59. Pas miratimit të urdhrin të ekzekutimit më 3 shtator 1006, zyra e përmbartimit mori masa të menjëhershme për të zbatuar vendimin e 13 gushtit 1996, duke sekuestruar pronën e shoqërisë. Megjithatë, këto përpjekje u penguan nga situata e përgjithshme që pati ndikim negativ në funksionimin normal të strukturave shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 1997. Qeveria kishte dokumentuar situatën në deklaratën e vitit 1997 për përjashtimin e detyrimeve të saj sipas Konventës. Duke pasur në konsideratë problemet e rendit publik me të cilat Shqipëria padyshim u përball në 1997, si dhe deklaratën e Qeverisë të bërë në përputhje me nenin 15§3 të Konventës, Gjykata çmon se vonesa, të paktën në lidhje me periudhën pas 2 tetorit 1996- data e hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me Shqipërinë- deri në heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, ishte e justifikuar (shihni *mutatis mutandis*, *Shestakov* (dhjetor), të cituar më lart).

60. Për më tepër, Gjykata vëren se në shtator 1997, u hapën procedimet e falimentimit në lidhje me shoqërinë private. Në prill 1998 u shpall falimentimi i shoqërisë private. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se autoritetet treguan kujdesin e duhur për trajtimin e procedurave të paaftësisë paguese. Më tej, ajo vëren se Shteti i paditur nuk mund të konsiderohet përgjegjës për mospagimin që lind nga një kërkesë e zbatueshme për shkak të falimentimit të një debitori “privat” (shihni *Sanglier kundër Francës*, nr. 50342/99, § 39, 27 maj 2003; krahasoni “*Cone kundër Rumanisë*”, nr.35935/02, § 31, 24 qershor 2008).

61. Është për të ardhur keq se emri i ankuesit nuk ishte përfshirë në listën e kreditorëve të shoqërisë së debitorit, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se të gjitha procedimet e brendshme filluan në Gjykatën e Rrethit, Vlorë. Në këtë kontekst, ajo vëren se administratori nuk arriti të paraqiste një ankim penal rreth ndjekjes penale të G.M për bërjen e deklaratave të rreme. Për më tepër, ankuesi nuk u ankua në asnjë fazë të procedimeve në lidhje me kufizime të të drejtave të tij për të kundërshtuar procedime të paaftësisë paguese, duke përfshirë vendimin e 17 prillit 1998 ose përfshirjen në listën e kreditorëve të shoqërisë (krahasoni “*Saggio kundër Italisë*”, nr.41879/98, §§42-44, 25 tetor 2001).

62. Më tej, Gjykata vëren se ankuesi u largua nga Shqipëria në një datë të papërcaktuar në vitin 1997. Vetëm në shtator 2005 ai u përpoq të vinte në lëvizje mekanizmin e ekzekutimit në lidhje me vendimin e 13 gushtit 1996. Ankuesi nuk iu referua ndonjë mase tjetër që autoritetet duhet të kishin marrë gjatë asaj kohe por që nuk mundën t'i ndërmerrnin. Për më tepër, asgjë në dosjen e çështjes nuk e çon Gjykatën në konkluzionin që shoqëria ishte zëvendësuar nga një strukturë e ngjashme, e cila do të mundësonte një zbatim të barazvlefshëm ose që procedura e falimentimit nuk kishte përfunduar ose se ka shuma financiare në dispozicion për kompensimin e ankuesit. Ankuesi nuk paraqiti dokumente ose prova për të kundërtën.

63. Fakti se në 1995 zyra e përmbartimit mori masa, me kërkesë të ankuesit, nuk ndryshon konkluzionet e Gjykatës që falimentimi i shoqërisë ishte shpallur në 1998 dhe se vendimi në favor të ankuesit nuk mund të zbatohet. Më tej, gjykata i drejtohet seksionit 11 të Ligjit të Falimentimit të vitit 1995, që parashikonte se vendimet e gjykatave që ishin transferuar kundër një pale përpara fillimit të procedimeve të tij të falimentimit, nuk ishin më detyruese pas fillimit të tyre.

64. Në këto rrethana, duke marrë parasysh se procedimet e ekzekutimit kishin filluar, se masat e zyrës së përmbartimit për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Rrethit të vitit 1996 u penguan në mënyrë të justifikueshme nga problemet e jashtëzakonshme të rendit publik në Shqipëri në 1997, se Shteti i paditur ishte përjashtuar nga detyrimet e tij në përputhje me nenin 15 të Konventës, se shoqëria falimentoit dhe se ankuesi nuk arriti të tregonte kujdesin e duhur në lidhje me zbatimin e një vendimi gjykate të formës së prerë në favorin e tij, Gjykata çmon se nuk mund të thuhet se ngjarjet kishin privuar të drejtën për akses të ankuesit të të gjithë efektit të dobishëm.

65. Në lidhje me moszbatimin pas rrëzimit të vendimit, Gjykata çmon se në këtë drejtim nuk lind asnjë çështje e veçantë, duke pasur parasysh konkluzionet e saj në lidhje me rrëzimin e vendimit të 13 gushtit 1996 (shihni paragrafët 44-53 më sipër).

66. Rezulton që ky ankim është haptazi i pabazuar sipas nenit 35 § 3 dhe rrjedhimisht i papranueshëm në përputhje me nenin 35§4 të Konventës.

3. Padrejtësia e pretenduar e procedimeve të rigjyimit në Gjykatën e Rrethit

67. Në parashtrimet e tij të 17 dhjetorit 2009, ankuesi, duke u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, u ankua se Gjykata e Rrethit kishte pushuar çështjen në mënyrë arbitrare dhe të pajustificueshme.

68. Gjykata vëren se procedimet e rigjyimit kishin përfunduar me vendimin e 3 dhjetorit 2007, në të cilat u vendos përfundimi i procedimeve. Ndërsa nuk rezulton që ankuesi të ketë depozituar ankim kundër vendimit ose të ketë kërkuar rivendosje në afat, më tej Gjykata vëren se ky ankim ishte paraqitur jashtë afatit gjashtë mujor të përcaktuar nga nenin 35 § 1 i Konventës.

69. Rrjedhimisht, Gjykata vendos të refuzojë këtë ankim në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Ankimi sipas nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës

70. Ankuesi u ankua se e drejta e tij për gëzimin paqësor të pronës së tij ishte shkelur si rezultat i moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të 13 gushtit 1996.

Neni 1 i Protokollit nr.1 parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të zotërimeve të tij. Askush nuk privohet nga zotërimet e tij përveç për interesin publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat pararendëse në asnjë mënyrë nuk cenojnë të drejtën e një Shteti për të zbatuar këto ligje që ai i çmon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave, kontributeve ose gjobave të tjera.”



71. Gjykata çmon se duke marrë parasysh konkluzionet e saj në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të 13 gushtit 1996 (shihni paragrafët 57-66 më sipër), ky ankim është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35§3 dhe rrjedhimisht i papranueshëm në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri
Shpall ankimin të papranueshëm.

Fatos Araci
Zëvendësregjistrues

Lech Garlicki
Kryetar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.12.2011
Doli nga shtypi më 7.12.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 16 lekë